

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Tonka Berishaj, kryetare, Driton Muharremi e Hava Haliti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit H.H. nga Prizreni, për shkak të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit H.H. të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.625/15 të datës 23.12.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur në pajtim me dispozitën e nenit 390 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), më 14.07.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e ankesës së mbrojtësit të akuzuarit H.H. nga Prizreni, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.625/15 të datës 23.12.2016, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës, konform nenit 364 par.1 pika 1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të akuzuarin H.H. e liron nga akuza:

Sepse duke qenë në cilësinë e personit zyrtar-kryetar i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), me qëllim që t'i mundësojë tjetrit përfitim të dobisë pasurore, i tejkalon kompetencat e tij ligjore në atë mënyrë që me dt. 03.10.2014 dhe 09.10.2014, në kundërshtim me dispozitat nga nenet 104, 105, 106 dhe 109 të Ligjit të Prokurimit Publik nr.04/L-042 (LPP), me dispozitat nga nenet 14, 23 dhe 36 të Rregullores së Punës së OSHP-së, dhe dispozitave nga nenet 97 dhe 99 të Ligjit të Procedurës Administrative nr.02/L-28 (LPA), duke vendosur me konkluzion si çështje “Res Judicata”, pa i shqyrtuar fare i ka refuzuar ankesat e operatorëve Ekonomik (OE) “NN1” NN2” të dt. 02.10.2014, dhe Konzorciumit “NN” SHPK të dt. 03.10.2014, të ushtruar kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues (AK) Kostt Sh.A. për aktivitetin e prokurimit “Instalimi i Grupeve Matëse në kufirin në mes të Kostt (KEK) OSSH” me nr.të prokurimit 14-12-84-511, me të cilin vendim Autoriteti Kontraktues pas procedurës së rivlerësimit, e kishte shpallur fitues OE “NN3” SHPK edhe pse kompetent për vendosje për ankesë ka qenë Paneli Shqyrtues i OSHP-së, dhe atë në përbërje prej pesë anëtarëve pasi vlera e kontratës së nënshkruar për këtë projekt ishte 2.327.240,19 €, ashtu që duke i tejkualuar autorizimet dhe kompetencat e tij, ia ka mundësuar fitimin e kontratës në këtë projekt operatorit ekonomik “NN3”.

Me çka kishte për të kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK-së,

Shpenzimet e procedurës penale i ngarkohen mjeteve buxhetore të gjykatës.

Ankesa e Prokurorit Themelor në Prishtinë, refuzohet si e pa bazuar.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin PKR.nr.625/15 të datës 23.12.2016, të akuzuarin H.H. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK, për çka e ka gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Ia ka ndaluar ushtrimin e funksioneve në Administratën Publike ose në Shërbimin Publik në kohëzgjatje prej 3 (tri)viteve, pas mbajtjes së dënimit me burgim. Të dëmtuarit L.G. dhe V.G. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil. I akuzuari është obliguar të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe 200 € në emër të paushallit gjyqësor.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka ushtruar :

-Mbrojtësi i të akuzuarit H.H., av.T.RR., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që ankesa të aprovohet dhe aktgjykimi i shkallës së parë të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës e caktoj dhe e mbajti seancën kolegjit konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPP, për të cilën i njoftoj palët. Në seancë nuk prezantoi Prokurori i Apelit edhe pse i ftuar me rregull, ndërsa prezent ishin i akuzuari H.H. dhe mbrojtësi i tij av. T.RR.. Mbrojtësi av. T.RR. mbeti pranë pretendimeve ankimore ndërsa i akuzuari H.H. mbështeti mbrojtësin e tij.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.206/17 të datës 27.04.2014 ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit H.H. av.T.RR. të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e kësaj lënde, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore konstatoi:

- ankesa duhet aprovuar dhe i akuzuari të lirohet nga akuza.

Mbrojtësi i të akuzuarit H.H. av. T.RR. pretendon me ankesë se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të

procedurës penale nga neni 384 par. 1 nënpar. 12 lidhur me nenin 370 par.6 dhe 7 të KPP-së pasi që gjykata nuk ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit si dhe lidhur me pretendimet e mbrojtjes të paraqitura në fjalën përfundimtare dhe të plotësuar edhe me sqarime shtesë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Nuk ka paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara si dhe nuk ka vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse. Nuk mund të dihet nga aktgjykimi se ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik në kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve a paraqet dënim apo masë siguruese pasi që sipas nenit 62 të KPRK-së i njëjti është dënim plotësues i cili shqiptohet me dënim kryesor ose alternativ prandaj të njëjtin është dashur ta shqiptoj në mënyrë të veçantë si dënim plotësues ashtu që aktgjykimin e bënë krejtësisht të paqartë dhe kundërthënëse. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se i akuzuari duke tejkualuar autorizimet e tij i ka mundur personit tjetër përfitimin e dobisë pasurore mirëpo nga ky aktgjykim nuk mund të kuptohet se cili është personi tjetër i cili ka përfituar dobi pasurore dhe sa është dobia e përfituar nga personi tjetër e që aktgjykimin e bënë po ashtu të paqartë. Sipas mbrojtjes vetëm fakti se i akuzuari ka vendosur me konkluzion lidhur me ankesat e OE të konzorciumeve “NN1 SRL & NTSH NN” të datës 02.10.2014 dhe konzorciumit “NN” Sh.p.k. të datës 03.10.2014 të ushtruara kundër vendimit të AK KOSTT Sh.a, vetvetiu nuk nënkupton se OE “NN” nuk është e mjaftueshme që të konstatohet se personi tjetër ka përfituar dobi pasurore për faktin se i njëjti ka kryer të gjitha punët për realizimin e këtij projekti si që është paraparë me kontratë. Po ashtu aktgjykimin është i paqartë edhe sa i përket vendit të kryerjes së veprës së pretenduar penale sepse në dispozitiv por as në arsyetim nuk theksohet vendi ku pretendohet se është kryer vepra penale. Po ashtu nuk përshkruhet se i akuzuari i ka shkelur dispozitat e LPP-së dhe Rregullores së Punës së OSHP me dashje ashtu si që e përcakton dispozita e nenit 422 të KPRK-së. Mungesa e vërtetimit të dashjes si element subjektiv i veprës penale e përjashton tërësisht përgjegjësinë penale të akuzuarit dhe nuk është vërtetuar fakti se i akuzuari a ka qenë i vetëdijshëm se veprimi i tij i vendosjes me konkluzion është i kundërligjshëm ose jo. Gjykata për këtë referohet në aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1063/13 i datës 05.06.2014 i cili është bërë i plotfuqishëm e ku është aprovuar kërkesëpadija e paditësit “NN” dhe është anuluar konkluzioni i OSHP-së, Pshnr.229/13, 231/13 të datës 15.07.2013 dhe çështja është kthyer në rishqyrtim dhe duke vlerësuar gabimisht se kinse z. H. vendosjen me konkluzion edhe në rastin konkret e ka bërë me qëllim. Këto aktgjykime mbrojtja thekson se nuk i ka siguruar gjykata sipas detyrës zyrtare por këto ia ka dorëzuar vet i akuzuari për të treguar se edhe në të kaluarën për të njëjtat çështje është vendosur me konkluzion dhe se kjo ka qenë praktikë standarde në punën e OSHP-së. Ky aktgjykim është bërë i plotfuqishëm me 09.03.2015 apo 5 muaj pas vendosjes nga ana e të akuzuarit me konkluzion e i cili është objekt i akuzës që tregon se i njëjti nuk ka qenë në dijeni lidhur me qëndrimet dhe praktikat e gjykatës se “vendosja e ankesave me konkluzion është në kundërshtim me ligjin dhe me praktikat gjyqësore”. Gjykata e shkallës së parë ka shkelur dispozitën e nenit 18 të KPP-së e që ka të bëjë me çështjet prejjudikuese. Kjo për faktin se OE “NN” Sh.p.k.ka paraqitur padi për konflikt administrativ me 07.11.2014 dhe se deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor në shkallë të parë në këtë çështje penale kjo gjykatë nuk ka marr vendim lidhur me konfliktin administrativ dhe se zbatimi i ligjit penal në rastin konkret varet nga vendimi paraprak në çështje administrative. Gjykata nuk ka vërtetuar me asnjë provë se H. ka përfituar për vete apo për OE “MNN” dhe se çdo

gjë ka ngel në nivel të dyshimit të arsyeshëm të bazuar në supozime dhe thashë e thëme të pavërtetuara.

Mbrojtësi thekson se gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar në mënyrë të saktë se a e ka kryer i akuzuari veprën (vendosjen me konkluzion) me dashje apo nga pakujdesia si pasojë e mundësisë së interpretimit të gabuar të dispozitave ligjore, në veçanti të LPP-së dhe LPA-së, vërtetim i faktit i cili është vendimtar për të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm. Vepra penale nga neni 422 të KPRK mund të kryhet me veprim ose me mosveprim por vetëm me dashje direkte speciale pasi që qëllimi i përfitimit për vete ose për personin tjetër apo dëmin e personit tjetër paraqet dashje direkte speciale dhe të gjitha këto janë të lidhura me qëllimin e kryesit për përfitim të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme për veti ose për tjetrin apo të shkakimit të dëmit personit tjetër. I mbrojturi i tij është shpallur fajtor për tejkalim të autorizimit zyrtar e kjo kryhet kur personi zyrtar vepron jashtë kompetencave të tij duke ndërmarr veprime të cilat janë në kompetencë të personit tjetër ose që janë kompetencë apo i përkasin një shërbimi krejtësisht tjetër e që në rastin konkret këto nuk qëndrojnë. Mbrojtja citon një aktvendim të gjyqtarit të EULEX për konfirmimin e aktakuzës në Gjykatën e Qarkut në Prizren KA.nr.161/10 të datës 11.10.2011 ku është hudhur aktakuza kundër dy të akuzuarave për shkak të veprës penale nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve nga neni 346 dhe shpërdorimi i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 i KPK-së e ku sipas këtij aktvendimi për tu vërtetuar faji penal duhet të plotësohen dy kushte dhe atë: nën 1. kriteri objektiv – vepra penale duhet të vërtetohet përtej dyshimit të bazuar mirë dhe 2. kriteri subjektiv që duhet të dëshmohet përtej dyshimit të bazuar mirë se kryesi i veprës penale ka kryer veprën penale me qëllim. Në këtë aktvendim gjykata ka vlerësuar se gjyqtarët zakonisht, edhe marrin vendime të gabuara për këtë arsye edhe është themeluar sistemi i ankesës me qëllim që të përmirësohen gabimet e gjyqtarëve dhe ndër të tjera konstaton se rrjedhimisht vendimi i gabuar i gjyqtarit nuk paraqet vepër penale në vete. Ky aktvendim është vërtetuar nga kolegji i Gjykatës së Qarkut në Prizren. Mbrojtja tërheq vëmendjen se gjykata e shkallës së parë nuk e ka të qartë dallimin në mes një vendimi të kundërligjshëm të nxjerr me qëllim qoftë në formë të konkluzionit nga vendimi i kundërligjshëm i nxjerr me qëllim. Sipas mbrojtjes z. H. si kryetar i OSHP-së ka të drejtë që lidhur me ankesat të vendos vet dhe me konkluzion. Nëse vërtetohet nga gjykata kompetente se është i gabuar mund të anulohet pasi për këtë mund të fillohet procedura e konfliktit administrativ. Mbrojtja thekson se i mbrojturi i tij ka qenë i akuzuar për vepra nga neni 283, 284, 242, 422, 431 dhe 428 të KPRK-së, ashtu që për të gjitha veprat përveç veprës penale nga neni 422 ka gjetur se në veprimet e të dyshuarve nuk qëndrojnë elementet e veprës penale dhe ka pushuar hetimet ndërsa ka ngritë aktakuzë vetëm për veprën penale nga neni 422 të KPRK-së. Pra nuk ka arritur të vërtetohet se i akuzuari ka përfituar për veti ose për tjetrin dobi pasurore, apo që i ka shkakuar dëm personit tjetër. I akuzuari nuk ka lidhje me asnjë prej operatorëve ekonomik e as lidhje biznesore, familjare apo shoqërore me pronarët apo me përfaqësuesit e operatorit ekonomik fitues dhe se mungesa e këtyre lidhjeve në mes z. H. dhe këtij operatori ekonomik është vërtetuar kur prokuroria ka pushuar hetimet për veprën penale konflikti i interesit nga neni 424 të KPRK-së. Mbrojtja në ankesë citon nenin 97 të LPA, nenin 18 par. 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nenin 109.1 të LPP-së, nenin 111 par. 1.5 të LPP-së, nenin 4.1.11 të LPP-së dhe nenin 119 par. 1 të LPP-së e të cilat i akuzuari thotë se ka besuar dhe edhe sot beson që si kryetar i OSHP ka pasur të drejtë që të vendos me konkluzion kur vlerëson se operatori ekonomik nuk e ka cilësinë e palës së interesuar dhe se çështja “Res Judicata” apo kur e vlerëson si

çështje dytësore. Mbrojtja thekson se konzorciumi “NN1 SRL & NTSH NN” nuk e ka pasur cilësinë e palës së interesuar pasi që me vendimin 205/14 të datës 04.08.2014 ky konzorcium është diskualifikuar si OE e papërgjegjshme nga OSH dhe AK “KOSTT” që do të thotë në fazën e dytë të rivlerësimit të njëjtë i ka munguar interesi material e jo ai juridik pasi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme në AK. Mbrojtësi konsideron se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të drejtë gjendjen faktike. Tërheq vërejtjen se duhet pasur parasysh tri fakte të rëndësishme për të vërtetuar gjendjen faktike dhe atë faktin se nuk është e logjikshme që dikush duke qenë i vetëdijshëm se vendosja me konkluzion lidhur me ankesat e OE është në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe Rregulloren e Punës së OSHP-së dhe me vetëdije të plotë dhe me qëllim të vendos me konkluzion; faktin se në OSHP shumë kohë më parë ka ekzistuar një praktikë standarde e punës që për raste të tilla apo të ngjashme të vendoset me konkluzion dhe se aktgjykimet të cilave iu referohet gjykata e shkallës së parë është bërë 5 muaj më vonë pasi që i akuzuari ka vendosur me konkluzion që tregon se nuk ka qenë në dijeni lidhur me këtë çështje. Mbrojtja vlerëson se dëshmia e dëshmitarit L.G. ka mospërputhje të rëndësishme për faktet vendimtare në mes të asaj që ka deklaruar në polici dhe në shqyrtim gjyqësor pasi në polici ka theksuar se ofertën e tenderit kishte dorëzuar edhe një dokument me logo të kompanisë “X “ me logo dhe nënshkrim por kjo kompani e ka mohuar se nënshkrimi në dokumentin e paraqitur nga dëshmitari është i tyre, e që ky fakt vërteton se OE “NN” ka qenë i papërgjegjshëm dhe me të drejtë është shpallë si i tillë. Po ashtu gjykata nuk e ka vlerësuar edhe pjesën e dëshmisë lidhur me kërkesat e AK që në tabelat teknike të mos plotësohet me PO dhe JO por të bëhet përshkrimi teknik, ndërsa subjekti i tij këtë e ka bërë me PO ose JO e që është fakt tjetër që ka qenë i papërgjegjshëm. Po ashtu edhe dëshmia e dëshmitari V.G. vërteton se kompania e tij ka qenë me diferencë shumë më të madhe në çmim mirëpo kundër kësaj përzgjedhje ka paraqitur ankesë “NN & G 3” dhe se ky dëshmitarë ka paraqitur ankesë kundër vendimit për shpalljen e fituesit pas kthimit të lëndës në rivlerësim kur ka marr përgjigje me konkluzion. Ky dëshmitarë ka dëshmuar se kur nuk është shpall fitues ka ofertuar me çmim më të lartë se kompania fituese për 60.000 €. E nga kjo del se vendosja me konkluzion nga ana e z. H. si kryetar i OSHP-së nuk e ka dëmtuar fare kompaninë “Y” dhe me të drejtë është vendos që kjo kompani nuk ka interes material për paraqitje të ankesës. Edhe dëshmitari Z.F. në dëshminë e tij ndër të tjera ka theksuar se nuk kanë qenë të angazhuar në çështjet që i vendos kryetari i panelit dhe se për herë të parë nuk vendoset me konkluzion por për çështjet e përsëritura e nga kjo del se i akuzuari drejtë ka vendos lidhur me ankesat e përsëritura me konkluzion pasi kemi të bëjmë me çështje të përsëritur dhe se OE “NN” i mungon interesi material të cilën e ka vërtetuar edhe dëshmitari V.G.. Nga dëshmia e dëshmitarit A.I. është vërtetuar se OE është dashur ti plotësojnë të dhënat e sakta e jo me PO ose JO dhe se të tillët janë eliminuar si të papërgjegjshëm. Gjukata nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe se ka qenë e domosdoshme që të angazhohet një ekspert i lëmisë së prokurimit për të vërtetuar faktet e pretenduara nga prokuroria e në veçanti: a kanë pasur interes material kompanitë ankesat e të cilëve janë refuzuar me konkluzion si Res Judikata; shkeljet e konstatuara nga ekspertet shqyrtues dhe të konstatuara edhe me vendimin e OSHP-së a paraqesin bazë të mjaftueshme ligjore që OE të shpallen të papërgjegjshëm edhe nëse lidhur me ankesat e tyre nuk do të ishte vendosur me konkluzion si Res Judikata të vërtetohen edhe faktet tjera të rëndësishme për marrjen e vendimit të drejtë dhe të ligjshëm.

Gjykata e Apelit me vëmendje ka shqyrtuar shkresat e lëndës së bashku me aktgjykimin e atakuar si dhe ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, ashtu që vlerëson se ajo është e bazuar. Nga shkresat e lëndës kjo gjykatë vlerëson se asnjëra nga provat të cilat janë administruar në shqyrtimin kryesor nuk ka vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Dispozitivi i aktgjykimit është i mangët dhe nuk përshkruan veprimet inkriminuese të akuzuarit në drejtim të kryerjes së veprës penale, për faktin se të njëjtit i mungon pala e dëmtuar, vlera e dëmit me anë të keqpërdorimit të supozuar dhe mënyra se si i paska mundësuar OE „ NN3” fitimin e kontratës. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i shkallës së parë përmban vetëm arsyetime lidhur me procedurat e prokurimit në Republikën e Kosovës dhe kronologjinë e procedurës së tenderimit për rastin në fjalë, flet për aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me konfliktin administrativ por asnjë arsyetim, vlerësim apo vërtetim në drejtim të përmbushjes së elementeve qenësore të veprës penale nga neni 422 par.1 të KPRK-së. Pa dashur që edhe një herë të elaborohet e tërë procedura e tenderimit dhe kronologjia e këtij rasti, për këtë gjykatë kanë qenë të rëndësishme me rastin e vendosjes në këtë çështje penale sqarimi i këtyre dilemave: E para, a ka ekzistuar dashja direkte e të akuzuarit për të kryer këtë vepër penale? Tejkalmimi i kompetencave nga ana e zyrtarit me qëllim përfitimi pasuror për vehte apo tjetrin? A i është shkaktuar dëm personit tjetër (kjo edhe ashtu nuk është theksuar në dispozitiv të aktgjykimit) ? Si dhe veprimet e të njëjtit a mund të konsiderohen vepër penale apo të njëjtat i takojnë domenit të kontesteve adminsitrateve apo civile?

Sipas dispozitës ligjore të nënit 422 par.1 të KPRK-së, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK, kjo vepër përmban atë se : „ *Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e personit tjetër*” . Për qëllime të këtij neni, shpërdorimi i detyrës zyrtare përfshinë, por nuk kufizohet në: *2.1. shkeljen me dashje apo me dijeni të ligjit lidhur me detyrat apo punësimin e zyrtarit; 2.2. moskryerja me dashje e ndonjë detyre të domosdoshme të përcaktuar me ligj; 2.3. pranimi i dhuratës, tarifës apo përparësisë së çfarëdo lloji si rezultat i kryerjes së detyrës zyrtare, përveç nëse pranimi i dhuratës, tarifës apo përparësisë lejohet me ligj; 2.4. keqpërdorimi i pasurisë, shërbimeve apo personelit qeveritar apo i ndonjë sendit tjetër me vlerë që i përket qeverisë e që ka rënë në kujdesin apo posedimin e zyrtarit si rezultat i detyrës apo punës së tij; 2.5. nënshtrimi me dashje i personit tjetër në keqtrajtim ose arrest, ndalim, kontroll, marrje, heqje, vlerësim ose barrë për të cilën e di se është e kundërligjshme; ose 2.6. ndalimi ose pengimi me dashje i tjetrit në ushtrimin apo gëzimin e ndonjë të drejte, privilegji, pushteti apo imuniteti ligjor.* Pra në këtë rast veprimi i kryerjes është përcaktuar në mënyrë alternative dhe vepra penale paraqitet në tri forma, që janë: *shfrytëzimi i pozitës zyrtare (shpërdorim) apo autorizimeve, tejkalmimi i autorizimeve zyrtare dhe mos përmbushja e detyrave zyrtare (moskryerja e detyrimeve zyrtare).* Në rastin konkret prokuroria por edhe gjykata e shkallës së parë pretendojnë se i akuzuari ka tejkaluar autorizimet e veta ligjore kur ka marrë konkluzionin në fjalë. Tejkalmimi i autorizimeve zyrtare ekziston kur personi zyrtar vepron jashtë autorizimeve zyrtare dhe jashtë kompetencave të tij reale. Kryesi i veprës penale tejkalon kufijtë e autorizimeve të veta zyrtare, ngase ndërmerr veprime zyrtare që cilat janë në kompetencë të një personi tjetër zyrtar (të një instance

më të lart; a më të ulët), ose që i përket një shërbimi krejtësisht tjetër (i ashtuquajtur i uzurpim). Vepra ekziston edhe kur personi zyrtar vepron pa pëlqimin dhe pa lejen paraprake të personit tjetër, e cila në rastin konkret është e domosdoshme. Për ekzistimin e kësaj forme të keqpërdorimit është e domosdoshme të vërtetohen kufijtë e autorizimit të presonit zyrtar, në bazë të dispozitave që kanë të bëjnë me këtë shërbim. Kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje të drejtpërdrejtë, e cila përfshin edhe dijeninë e kryesit se po e shfrytëzon pozitën e tij zyrtare, po tejkalon kompetencat e tij ose nuk pe kryen detyrën e tij, si dhe faktin se me këtë ai përfiton dobi pasurore për vete apo për tjetrin, ose i shkakton tjetrit çfarëdo dëmi. Keqpërdorimin te ky nen e përcakton veprimi i caktuar dhe qëllimi i caktuar. Nuk është e thënë që çdo keqpërdorim të jetë patjetër vepër penale. Në raste të caktuara, ai mund të ketë vetëm karakter të përgjegjësive disiplinore ose të ndonjë përgjegjësie tjetër. Kur flasim për format e fajit vepra penale mund të kryhet vetëm me dashje, madje vetëm me dashje të drejtpërdrejtë, ngase, për ekzistimin e veprës penale është i nevojshëm sigurimi për vete ose për tjetrin i çfarëdo përfitimi (material ose jomaterial), shkaktimi i dëmit një personi tjetër, ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e shkelja serioze e të drejtave të personit tjetër, çka do të thotë se çdo keqpërdorim i detyrës zyrtare nuk nënkupton edhe konsumimin e kësaj vepre penale (ajo mund të tërheqë përgjegjësi disiplinore, por jo edhe përgjegjësi penale, pa u vërtetuar dashja e drejtpërdrejtë e të pandehurit për të realizuar ndonjëherë nga alternativat që kërkohen me ligj - përfitimin, dëmin-shkeljen).

Prandaj duke i pasur parasysh këto që u theksuan më lart kjo gjykatë vlerëson se me asnjë provë nuk është vërtetuar dashja direkte e të akuzuarit H.H. që i njëjti përmes tejkalimit të kompetencave ka përfituar për vehte ose tjetrin dobi pasurore ose ti ketë shkaktuar dëm personit tjetër. Ky pretendim i prokurorisë si palë tek e cila bie barra e provës por edhe nga gjykata e shkallës së parë nuk u provua me asnjë provë. Po ashtu duke pasur parasysh ato që i thekson edhe mbrojtja se nenet 97 të LPA e cila rregullon rastet kur vendoset me konkluzion, neni 18 par. 3 i Rregullores së Punës së OSHP-së, ku thuhet se „ Kryetari i Panelit shqyrtues lidhur me rastet e përsëritura me pretendime të njëjta ankimore të shqyrtuara më parë duhet të vendos me konkluzion si çështje e shqyrtuar një herë-Res Judicata”, neni 109.1 të LPP-së, mundësia e dorëzimit të ankesave nga palët e interesuara, neni 111 par. 1.5 të LPP-së, që ka të bëjë me shqyrtimin e ankesës vetëm nëse kualifikohet si „ palë e interesuar”, neni 4.1.11 të LPP-së, që ka të bëjë me atë se parashtrues i ankesës është pala e interesuar..., dhe neni 119 par. 1 të LPP-së, që është mundësia e kërkimit nga gjykata që ta shqyrtoj vendimin, nga këto dispozita ligjore vërtetohet se përveç praktikave që kanë ekzistuar më parë në OSHP që të vendoset me konkluzion nga kryetari i panelit të rastet e përsëritura, këto dispozita ligjore të japin të kuptosh se veprimet e të akuzuarit assesi nuk mund të kualifikohen si veprime inkriminuese penale pasi që i njëjti duke pasur parasysh këto dispozita ligjore, si dhe faktin se OE i cili është ankuar më parë nga paneli i OSHP-së prej 5 anëtarëve është shpallur i pa përgjegjshëm, ka vendosur me konkluzion duke e trajtuar tani ankesën si procedurë të përsëritur e për të cilën një herë është vendosur. Ndërsa fakti se Gjykata Themelore në Prishtinë për rast të ngjashëm, në konflikt administrativ ka anuluar konkluzionin e OSHP-së dhe çështjen e kthen në rishqyrtim, kjo vetëm e forcon bindjen e kësaj gjykate se kanë ekzistuar praktika të ngjashme të vendosjes në të kaluar në OSHP, dhe se vendimi paska shkelje administrative për të cilat duhet kthyer në rishqyrtim. Kjo e vërteton edhe atë që u tha më lart se jo çdo veprim i kundërligjshëm është vepër penale në mungesë të dashjes por se një veprim i tillë tërheqë përgjegjësi disiplinore.

Prandaj në rastet kur në mungesë të dashjes direkte merret një vendim apo konkluzion që në procedurë administrative konsiderohet si e kundërligjshme, ekziston mundësia e ankimimit në gjykatën kompetente e cila do te evitonte shkaktimin e dëmit tjetrit pa fajin e personit zyrtar. Në rastin konkret edhe pse gjykata në procedurë administrative ka anuluar konkluzionin në fjalë, në rivlerësim OSHP, me një përbërje komplet tjetër ka vendosur me aktvendimin PSH.nr.312/17 të datës 06.07.2017 që të i refuzohet ankesa OE “NN” Sh.p.k , dhe ka vërtetuar vendimin e AK-se, për dhënien e kontratës „ Np NN dhe G3 Inxhinjering” lidhur me instalimin e grupeve matëse në kufirin në mes KOSTT/KEK/OSSH me numër prok.14-12-84-511, me arsyetim ndër të tjera se konsorciumi ankues nuk ka mundur të dëshmojë se shkelja e supozuar i ka shkaktuar dëm OE dhe njëkohësisht me këto rrethana dhe fakte i njëjti operator në asnjë variant nuk ka mundur të shpallet fitues. Kjo në rrethanat në të cilat është akuzuar dhe shpallur fajtor edhe nuk ka ndonjë rëndësi pasi që në dispozitiv i akuzuari nuk akuzohet se i ka shkaktuar dëm personit tjetër por se me tejkalim të autorizimeve i ka mundësuar tjetrit fitimin e kontratës në këtë projekt.

Duke pasur parasysh se në rastin konkret nuk vërtetohet dashja direkte e të akuzuarit H.H. për të kryer veprën penale si element konstituiv i veprës penale, nuk u vërtetua se me veprimin e tij ka përfituar për vehte apo tjetrin dobi pasurore, në mungesë të dëmit për personin tjetër, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e liruar të akuzuarin nga përgjegjësia penale dhe se me bindje të thellë duke vlerësuar se veprimet e të akuzuarit nuk hyjnë në sferën penale.

Prandaj bazuar në ato që u cekën më lart e duke marrë parasysh faktin se Gjkata me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të akuzuarit e duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPP., *parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin In Dubio Pro Reo*, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. E në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë në dëm të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të bazuar dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet të konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë në favor të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.

Nga çka u tha më lart, e në pajtim me dispozitën e nenit 403 të KPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit – gjyqtarja,
1. Tonka Berishaj

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi _____

3. Hava Haliti _____